


**ANALIZË E
PREMTIMEVE
DHE POLITIKAVE
KOMBËTARE
PËR RININË DHE
ARSIMIN
2013 – 2021**



PËRMBAJTJE

1. Hyrja
2. Metodologjia
3. Premtimet për arsimin dhe rininë 2013 – 2017
4. Premtimet për arsimin dhe rininë 2017 – 2021
5. Pakti për Universitetin 2018 -2020
6. Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015 – 2020
7. Prioritetet për rininë dhe arsimin 2021 - 2025

Ekipi realizues:

Rigels Xhemollari

Tea Zeqaj



Kjo është një analizë e përgatitur nga ekipi dhe ekspertët e Qëndresës Qytetare me mbështetjen e Olof Palme Center. Gjetjet, rekomandimet dhe opinionet e shprehura në këtë monitorim, nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të donatorit.

1. Hyrje

Qëndresa Qytetare është një organizatë e fokusuar në çështjet e arsimit dhe rinisë ku prej 4 vitesh monitoron politikat qeveritare duke adresuar shqetësimet e komunitetit të të rinjve dhe studentëve. Viti 2021 do të jetë një vit zgjedhor dhe për rrjedhojë lind nevoja për të bërë një bilanc të premtimeve të mbajtura dhe politikave të zbatuara gjatë dy mandateve qeverisëse. Qëndresa Qytetare do të analizojë premtimet dhe politikat e zbatuara gjatë 8 viteve të fundit, nivelin e realizimit të tyre dhe nevojën për të riparë dhe rikonsideruar nga aktorët politikë çështjet me interes të lartë për të rinjtë dhe studentët. Kjo nismë i shërben nxitjes dhe orientimit të debatit konstruktiv, të bazuar në fakte dhe evidenca për të përmirësuar cilësinë e ofertave politike për rininë dhe arsimin nga forcat politike që konkurojnë në zgjedhjet e 25 Prillit.

Pjesë e kësaj analize do të jenë:

- **Premtimet e qeverisë 2013 – 2017**
- **Premtimet e qeverisë 2017 – 2021**
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015 - 2020**
- **Pakti për Universitetin 2019 – 2021**

Ekipi i Qëndresës realizoi 20 intervista dhe 2 fokus grupe me të rinj dhe studentë për të mbledhur opinione, qëndrime dhe sugjerime për çështjet të cialt dueht të jenë në fokus të programeve të partive politike sa i përket fushës së arsimit dhe rinisë. Këto propozime do të jenë pjesë integrale e këtij studimi në funksion të orientimit të debatit publik dhe përmirësimit të ofertës zgjedhore. Gjithashtu gjatë fushatës zgjedhore Qëndresa Qytetare do të arkivojë premtimet zgjedhore të bëra në fushatë nga forcat kryesore politike dhe do të monitorojë zbatimin e tyre pas zgjedhjeve.

2. Metodologjia

Qëndresa Qytetare evidentoi të gjitha premtimet e shkruara në programet qeverisëse dhe ato të partive politike të cilat kanë drejtuar vendin me fokus arsimin dhe rininë. Pas evidentimit u gjeneruan të dhënat mbi ecurinë e realizimit të tyre nëpërmjet kërkesave për informacion, punës kërkimore dhe verifikimit të fakteve nga statistikave zyrtare.

Sa i përket politikave në nivel kombëtar të hartuara dhe miratuara nga qeveria 2015 - 2021 u morën në shqyrtim ecuritë e 2 politikave kryesore që lidhen me arsimin dhe rininë që janë Pakti për Universitetin dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë. Ekipi i Qëndresës Qytetare analizoi përmbushjen e objektivave dhe zbatimin e akteve ligjore të këtyre politikave duke evidentuar nivelin e zbatimit, buxhetimit dhe efektit të tyre tek të rritur dhe studentët. Në këtë kuptim paraqitja e objektivave dhe premtimeve të tyre do të shoqërohet me treguesit e mëposhtëm:

Premtimet klasifikohen në 3 kategori:

I Mbajtur:

Premtim i zbatuar, i buxhetuar dhe i veshur me kuadër ligjor.

I Pambajtur:

Premtim i pa zbatuar, i pa buxhetuar dhe pa kuadër ligjor.

Pjesërisht i Mbajtur:

Premtim i zbatuar, i buxhetuar dhe i veshur me kuadër ligjor pjesërisht.

Kjo metodologji do të ndihmojë publikun dhe komunitetin e të rinjve për të kuptuar dhe bërë dallimin e përmbushjës së një objekti real efektiv nga një objektiv i realizuar në letër ose në fasadë por jo në përmbajtje.



3. PREMTIMET ELEKTORALE PËR ARSIMIN DHE RININË 2013 – 2017

FORCAT QEVERISËSE: PARTIA SOCIALISTE DHE LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM

Në zgjedhjet e vitit 2013 koalicioni fitues ishte “Aleanca për Shqipërinë Europiane” i kryesuar nga Partia Socialiste dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, por i përbërë në total nga 34 parti politike. Pavarësisht se rinia dhe arsimi nuk ishin në fokus kryesor të programit qeverisës, mazhoranca mori përsipër disa anagzhime në këto sektorë në programin e saj qeverisës. Qëndresa Qytetare analizoi përmbajtjen e të gjitha premtimeve dhe zotimeve në programin qeverisës 2013 – 2017 duke evidentuar sasinë dhe efektivitetin e premtimeve për arsimin dhe rininë.

Premtimi 1

Financimi publik për arsimin të arrijë në nivelin e 5% e PBB

I Pambajtur

Qeveria e re në vitin 2013 premtoi se nga 2% e GDP do ta risë financimin publik për arsimin në 5% e GDP¹. Vitin e fundit të mandatit qeverisës financimi për arsimin ishte në vlerën 2.9% e GDP, pra një premtim i pambajtur sipas programit politik dhe qeverisës, një premtim i cili nuk u realizua as gjatë mandatit të dytë qeverisës pavarësisht se ishte edhe kërkesa e parë e protestës studentore në vitin 2018.

Premtimi 2

Nuk do të ketë asnjë shkollë me tre turne dhe asnjë klasë me më shumë se 30 nxënës.²

I Mbajtur

Në vitin 2017 sipas statistikave zyrtare nuk janë raportuar raste të shkollave me tre turne, apo të klasave me më shumë se 30 nxënës. Kjo ka ardhur jo vetëm për shkak të ndërtimit të shkollave të reja por edhe

¹ Programi qeverisës i Aleancës për Shqipërinë Europiane fq. 47

² Programi qeverisës i Aleancës për Shqipërinë Europiane fq. 47 - 48

për shkak të reduktimit të numrit të përgjithshëm të nxënësve në Republikën e Shqipërisë.

Premtimi 3

Krijimi i “Kartës së Performancës së Shkollës”

I Mbajtur

Karta e Performancës së Shkollës është një instrument që ofron të dhëna për arritjet e shkollës gjatë një viti shkollor duke shërbyer si një dokument për prindërit dhe drejtuesit për të vlerësuar diferencat e arritjeve në cdo vit.³ Ky premtim i qeverisë u vesh me kuadër ligjor në fund të vitit 2014 nëpërmjet Urdhrit 9142 të Ministrit të Arsimit dhe u bë funksional në vitin 2015.⁴

Premtimi 4

Cdo nxënës që duhet të udhëtojë në këmbë mbi 20 minuta për të shkuar në shkollë, do të këtë transport falas të garantuar.⁵

Pjesërisht i Mbajtur

Në 25 shtator 2015 qeveria nxorri vendimin për të marrë përsipër kostot e transportit të nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore, të cilët punojnë jashtë qendrave urbane. Por 3 muaj më vonë në 27 Dhjetor 2015 me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1001, datë 25 dhjetor 2015, organizimi i transportit të nxënësve dhe mësuesve kalon nga drejtoritë arsimore rajonale në përgjegjësi të njësive të qeverisjes vendore. Në maj të vitit 2016, Elbasani u bë bashkia e parë në vend që nëpërmjet një kontrate me vlerë 12.8 milionë lekë me TVSH ofroi shërbimin e transportit të nxënësve dhe mësuesve në shkollat nëntëvjeçare dhe të mesme të njësisë administrative vendore. Pavarësisht iniciativës kjo nismë nuk u zbatua në të gjithë territorin e vendit dhe në ato bashki që u zbatua pati ankesa të shumta lidhur me respektimin e standarteve, orareve, kushteve dhe zbatimin jo tërësor, ku edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është shprehur disa herë për mohimin e këtij transporti për nxënësit që vinin nga familje Rome dhe Egjyptiane.⁶

³ Programi qeverisës i Aleancës për Shqipërinë Europiane fq. 47 - 48

⁴ https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/Karta_e_performances-1.pdf

⁵ Programi qeverisës i Aleancës për Shqipërinë Europiane fq. 47 - 48

⁶ <https://kmd.al/wp-content/uploads/2019/07/vendim-176-16.12.2015.pdf>

Premtimi 5

Qeveria do të realizojë ngritjen e qendrave këshillimore për karrierën në shkollat e mesme⁷

I Pambajtur

Nuk pati asnjë iniciativë për të ngritur qendra të këshillimit të karrierës në shkollat e mesme, të cilat do ti vinin në ndihmë maturantëve dhe nxënësve për t'u orientuar në përzgjedhjen e degëve të studimit.

Premtimi 6

Ngritja e një organizmi të drejtë e të pavarur vlerësimi, akreditimi, dhe renditjeje të universiteteve publike dhe jopublike.⁸

I Mbajtur

Në vitin 2016 u krijua Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), me qëllim realizimin e procesit të vlerësimit për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit që ato ofrojnë, si dhe monitorimin në vijimësi të cilësisë së tyre. Në vitin 2017 kishim 36 institucione të arsimit të lartë të akredituara, por ekspertët shprehen kritikë për këtë proces duke e targetuar si procese që nuk ndikon sa duhet në politikën institucionale.

Premtimi 7

Mbyllja e universiteteve që nuk plotësojnë kriteret e ligjshmërisë.⁹

I Mbajtur

Në vitin 2014 pas verifikimit të ligjshmërisë, qeveria u hoqi licencën 17 universiteteve dhe shkollave të larta private duke mbyllur përgjithmonë aktivitetin e tyre në fushën e edukimit.¹⁰

⁷ Programi qeverises i Aleancës për Shqipërinë Europiane fq. 47 - 48

⁸ Programi qeverises i Aleancës për Shqipërinë Europiane fq. 47 - 48

⁹ Programi qeverises i Aleancës për Shqipërinë Europiane fq. 47 - 48

¹⁰ <http://www.gazetatema.net/2014/08/04/mbyllen-disa-universitete-dhe-shkolla-te-larta-privaterama-na-vjen-keq-por-splotesojne-kushtet/>

Premtimi 8

Do të krijohet një fond i veçantë për rijetësimin e organizatave rinore, ngritjen e Qendrave Rinore.¹¹

I Pambajtur

Gjatë 4 viteve të qeverisjes nuk u krijua asnjë fond i posaçëm për mbështetjen e organizatave rinore dhe nuk u ndërtuan qendra të mirëfillta të reja rinore shumë funksionale në shërbim të komuniteti të të rinjve. Në vitin 2015 u miratua Plani Kombëtar për Rininë i cili parashikoi ngritjen e qendrave rinore, 4 prej të cilave u mundësuan vetëm në 4 bashki, në mandatin e dytë qeverisës por edhe këto pa programe për të përfshirë të rinjtë por vetëm si hapësira në dispozicion të organizatave rinore.

Premtimi 9

Do të krijohen “Inkubatorët e Biznesit Rinor” që u mundësojnë të rinjve sipërmarrës hapësira për zyra, kryerjen e aktivitetit dhe lehtësira administrative.¹²

I Pambajtur

Në fund të mandatit qeverisës nuk u krijuan kushtet dhe hapësirat për ti mundësuar zhvillim biznesit rinor. Nisma mbeti një premtim i pa buxhetuar dhe i pa veshur me kuadër ligjor.

Premtimi 10

Do të nxitet sistemi i kredive dhe mikrokredive, si dhe do të krijohen lehtësira fiskale për sipërmarrjet e të rinjve.¹³

I Pambajtur

¹¹ Programi qeverisës i Aleancës për Shqipërinë Europiane fq. 47 - 48

¹² Programi qeverisës i Aleancës për Shqipërinë Europiane fq. 47 - 48

¹³ Programi qeverisës i Aleancës për Shqipërinë Europiane fq. 47 - 48

PREMTIMET PËR ARSIMIN DHE RININË 2013 - 2017

FORCAT QEVERISËSE:
PARTIA SOCIALISTE DHE
LËVIZJA SOCIALISTE PËR
INTEGRIM



	Premtimi	Realizimi
1	Financimi publik për arsimin të arrijë në nivelin e 5% e PBB	
2	Nuk do të ketë asnjë shkollë me tre turne dhe asnjë klasë me më shumë se 30 nxënës.	
3	Krijimi i "Kartës së Performancës së Shkollës"	
4	Cdo nxënës që duhet të udhëtojë në këmbë mbi 20 minuta për të shkuar në shkollë, do të ketë transport falas të garantuar.	
5	Qeveria do të realizojë ngritjen e qendrave këshillimore për karrierën në shkollat e mesme	
6	Ngritja e një organizmi të drejtë e të pavarur vlerësimi, akreditimi, dhe renditjeje të universiteteve publike dhe jopublike.	
7	Mbyllja e universiteteve që nuk plotësojnë kriteret e ligjshmërisë.	
8	Do të krijohet një fond i veçantë për rijetësimin e organizatave rinore, ngritjen e Qendrave Rinore.	
9	Do të krijohen "Inkubatorët e Biznesit Rinor" që u mundësojnë të rinjve sipërmarrës hapësira për zyra, kryerjen e aktivitetit dhe lehtësira administrative.	
10	Do të nxitet sistemi i kredive dhe mikrokredive, si dhe do të krijohen lehtësira fiskale për sipërmarrjet e të rinjve.	

I MBAJTUR | I PAMBAJTUR | PJESËRISHT I MBAJTUR



4. PREMTIMET PËR ARSIMIN DHE RININË 2017 – 2021

FORCA QEVERISËSE: PARTIA SOCIALSITE

Premtimi 1

Do të ndërtojmë 140 shkolla të reja për 40 000 nxënës.¹⁴

I Pambajtur

Sipas burimit të informacionit nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nga vitit 2017 deri në muajin shkurt 2021 janë ndërtuar **vetëm 7 shkolla të reja**.

Premtimi 2

Sigurim i ushqimit për nxënësit në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar¹⁵

I Pambajtur

Në muajin shkurt 2021 **vetëm 5 shkolla** në të gjithë Shqipërinë sigurojnë ushqim për nxënësit, 3 prej tyre në Tiranë, 1 në Korçë dhe 1 në Vlorë.

Premtimi 3

Mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara¹⁶

I Mbajtur

Numri i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuar për vitin shkollor 2021 – 2022 është në total 1275 mësues, ku 99 prej tyre janë të anagzhuar në arsimin privat.

¹⁴ Manifesti i Partisë Socialiste 2017 – 2021 fq. 120

¹⁵ Manifesti i Partisë Socialiste 2017 – 2021 fq. 121

¹⁶ Manifesti i Partisë Socialiste 2017 – 2021 fq. 119

2017-2021

Premtimi 4

Të gjitha shkollat e vendit do të jenë pjesë e nismës “Shkolla Qendër Komunitare”.¹⁷

Pjesërisht i mbajtur

Në fillim të vitit 2017 qeveria kishte arritur të kthente 225 shkolla në qendra komunitare. Premtimi elektoral i vitit 2017 ishte, kthimi i të gjitha shkollave të vendit në qendra komunitare, por sipas të dhënave që disponon Qëndresa Qytetare, në muajin shkurt 2021 numri i shkollave të kthyera në qendra komunitare është 270, pra në 4 vite kësaj nisme i janë shtuar vetëm 45 shkolla.

Premtimi 5

Do të digjitalizohen plotësisht kurrikulat e arsimit parauniversitar.¹⁸

Pjesërisht i mbajtur

Aktualisht në sistemin parauniversitar shkollor janë digjitalizuar pjesërisht vetëm 21 tituj tekstesh për klasën e 10-të, 15 tituj tekstesh për klasën e 11-të dhe 23 tituj tekstesh për klasën e 12-të. Por pavarësisht procesit të digjitalizimit venia në përdorim e tyre mbetet ende një proces problematik për shkak të mungesës së infrastrukturës digjitale në shkolla.

Premtimi 6

Deri në vitin 2021, çdo fëmijë rom dhe egjiptian, do të regjistrohet në shkollë dhe 100% e tyre do të mbarojnë arsimin e detyruar¹⁹

Pjesërisht i mbajtur

Sipas raportit të publikuar nga Këshilli i Europës dhe Komisioni European kundër racizmit dhe intolerancës në raport me vitin 2015 ku në sistemin arsimor të detyruar ishin vetëm 48% e fëmijëve rom dhe

¹⁷ Manifesti i Partisë Socialiste 2017 – 2021 fq. 118

¹⁸ Manifesti i Partisë Socialiste 2017 – 2021 fq. 118

¹⁹ Manifesti i Partisë Socialite 2017 – 2021 fq. 117

egjyptianë, në vitin 2018 kjo shifër u rrit në masën 66%, por jo sa ishte pretendimi dhe premtimi, pra në amsën 100%.

Premtimi 7

Ngritja e 61 qendrave të punësimit dhe karrierës dhe çdo bashki të ketë të paktën 1 shkollë profesionale të specializuar në nevojat e tregut lokal. ²⁰

I Pambajtur

Nga të dhënat e Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe verifikimi i faktit nga burime të besuara rezulton se ky është një premtim i pambajtur.

Premtimi 8

Rritje me 40% e pagës së mësuesve.²¹

Pjesërisht i mbajtur

Pagat e mësuesve të shkollave 9-vjeçare deri në vitin 2021 janë rritur me 21.6%, dhe ato të shkollave të mesme me 21.3%, pavarësisht premtimit se paga e mësuesve do të rritej në vlerën 40%.

Premtimi 9

Garantim i statusit të pedagogut.²²

I mbajtur

Nëpërmjet VKM nr 329 qeveria ka garantuar statusin dhe trajtimin e vecnatë të pedagogut i cili konsiston në liritë akademike, të drejtat ekonomiko – financiare, detyrimet dhe përgjegjësite dhe garancite juridike e civile në zbatim të tyre.

²⁰ Manifesti i Partisë Socialite 2017 – 2021 fq. 121

²¹ Manifesti i Partisë Socialite 2017 – 2021 fq. 121

²² Manifesti i Partisë Socialite 2017 – 2021 fq. 123

PREMTIMET PËR ARSIMIN DHE RININË 2017 - 2021

FORCAT QEVERISËSE:
PARTIA SOCIALSITE



	Premtimi	Realizimi
1	Do të ndërtojmë 140 shkolla të reja për 40 000 nxënës	
2	Sigurim i ushqimit për nxënësit në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar	
3	Mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara	
4	Të gjitha shkollat e vendit do të jenë pjesë e nismës "Shkolla Qendër Komunitare"	
5	Do të digjitalizohen plotësisht kurrikulat e arsimit parauniversitar	
6	Deri në vitin 2021, çdo fëmijë rom dhe egjiptian, do të regjistrohet në shkollë dhe 100% e tyre do të mbarojnë arsimin e detyruar	
7	Ngritja e 61 qendrave të punësimit dhe karrierës dhe çdo bashki të ketë të paktën 1 shkollë profesionale të specializuar në nevojat e tregut lokal.	
8	Rritje me 40% e pagës së mësuesve	
9	Garantim i statusit të pedagogut	

I MBAJTUR | I PAMBAJTUR | PJESËRISHT I MBAJTUR

5. PAKTI PËR UNIVERSITETIN 2018 -2020

FORCA QEVERISËSE: PARTIA SOCIALSITE

Protesta e studentëve në dhjetor 2018 arriti që në mungesë të drejtimit apo orientimit nga ndonjë subjekt politik apo shoqëror, t'i imponohet qeverisë me 8 kërkesa që lidheshin me reduktimin e tarifave, transparencën e shpenzimeve, përfaqësimin studentor, performancën në mësimdhënie dhe vetingun e titujve akademikë. Një pjesë e kërkesave kishin qenë edhe pjesë e premtiemve elektorale të mazhorancës në vitin 2013 dhe 2017.

Si rezultat i masivitetit, qëndrueshmërisë dhe kërkesave të drejta, studentët iu imponuan qeverisë dhe kryeministrit duke i detyruar të publikojnë “Paktin për Universitetin” një paketë

premtimesh dhe masash që u shpall nga kryeministri në 19 Dhjetor 2018 në Universitetin “Ismail Qemali” në Vlorë dhe më pas u konkretizua në 11 VKM dhe 4 Urdhëra të Kryeministrit në 26 dhjetor 2018, akte të cilat synuan të adresonin një pjesë të 8 kërkesave të formuluar dhe kërkuara nga studentët gjatë protestës.

Qëndresa Qytetare nëpërmjet nismës “Arsimi në Fokus” me mbështetjen e Qendrës Olof Palme, monitoroi implementimin e “Paktit për Universitetin” duke përfshirë çdo akt, afat, vendim apo iniciativë të adresuar në këtë dokument politikash.²³

²³ <https://qq.com.al/index.php/2020/01/30/monitorimi-i-paktit-per-universitetin184/>

PREMTIMET E PAKTI PËR UNIVERSITETIN 2019 - 2020

FORCAT QEVERISËSE:
PARTIA SOCIALISTE



	Premtimi	Realizimi	Efektiviteti
1	Reduktimi i tarifave në masën 50% dhe dhënia e bursave për studentët ekselentë dhe ata nga familejt në nevojë.		
2	Investimet në Konvikte. Ndërtimi i Kampusit Universitar.		
3	Portali U-Transparenca		
4	Zgjedhja e Anëtarit të Bordit të Administrimit nga Studentët		
5	Karta e Studentit		
6	Kontrolli Anti – Plagjiaturë		
7	Sondazhi Kombëtar i Studentëve		
8	Bibloteka Digjitale		
9	1000 vende pune për studentët ekselentë		
10	Krijimi i Fondit të Solidaritetit		

I MBAJTUR
JO EFEKTIV

I PAMBAJTUR
EFEKTIV

PJESËRISHT I MBAJTUR
DISI EFEKTIV

6. PLANI KOMBETAR I VEPRIMIT PER RININE 2015 – 2020

FORCAT QEVERISËSE: PARTIA SOCIALISTE DHE LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM

1.

Ngritja e Shërbimit Kombëtar të Rinisë në Tiranë dhe ngritja e

Qendrave Rinore në çdo rajon.²⁴

Pjesërisht i Mbajtur

Shërbimi Kombëtar për Rininë është aktualisht një institucion i ngritur në varësi të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe zbaton, ndjek politikën dhe strategjitë për Rininë duke funksionuar nëpërmjet Qendrave në nivel lokal dhe kombëtar. Aktualisht me ligjin e ri për rininë kjo strukturë do të ndryshojë emër dhe natyrë. Gjatë 5 viteve zbatim të planit kombëtar për rininë u krijuan vetëm 4 nga 12 qendra rinore që ishin parashikuar për tu ndërtuar. Katër qendrat e vëna në dispozicion për të rinjtë kanë funksionuar vetëm si hapësira në dispozicion të organizatave sesa si qendra me program të dedikuar për të rinjtë e bashkive ku ndodheshin.

2.

Portali i këshillimit të karrierës për të rinjtë www.rinia.al²⁵

i Pambajtur

Një ndër objektivat e Planit të Veprimit për Rininë ka qenë ndërtimi dhe fuqizimi i Portalit Rinia.al brenda vitit 2015 – 2017 me informacione periodike dhe të përditësuara mbi legjislacionin e punësimit, procedurave mbi hapjen dhe sistemet e taksimit të biznesit, tregut të punës, skemave mbështetëse për sipërmarrjet rinore, e të tjera. Pra një manual online për të nxitur dhe stimuluar punësimin rinor. Sot ky portal nuk ekziston megjithëse ka qënë i parashikuar në plan së bashku me buxhetin përkatës 442.000 lekë.

²⁴ Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë fq. 12

²⁵ Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë fq. 27

3.

AMSHC krijon fondin specifik, ku 20 % e fondeve duhet të shkojnë për organizatat rinore²⁶

i Pambajtur

Sipas planit Kombëtar të Veprimit për Rininë Agjensia Shqiptare për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) duhet të krijonte një fond specifik për mbështetjen e aktiviteteve të organizatave apo grupimeve rinore. Përlogaritja e kostos për këtë objektiv është bazuar në fondin vjetor të AMSHC- së prej 90,000,000 lekë/vit , nga i cili 20% mendohet të përdoret për rininë, pra rreth 18,000,000 lekë/vit duke filluar nga viti 2016. Sipas monitorimit tonë dhe përgjigjes zyrtare të ardhur nga ky institucion, jo vetëm që fondi specifik nuk është krijuar, por organizatat rinore aknë aplikuar njëkohësisht me organizatat me shumë vite eksperiencë në Shqipëri brenda të njëjtës thirrje, faktor ky dekurajues për fuqizimin e organizatave të reja.

4.

Krijimi Bordit Rinor Këshillimor në MMSR

i Pambajtur

Krijimi i Bordit Rinor Këshillimor në MMSR si një strukturë këshilluese nga të rinjtë në të gjitha fazat e vendimmarrjes e hartimit dhe monitorimit të politikave rinore.

5.

Hartimi i Ligjit mbi Vullnetarizmin²⁷

Pjesërisht i Mbajtur

Në Prill të vitit 2016 u miratua ligji për vullnetarizmin i cili synonte një rregullim ligjor të vullnetarizmit me synimin për të rritur pjesëmarrjen e individëve në jetën sociale, për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet si dhe zhvillimin e vlerave të solidaritetit njerëzor. Shumë të rinj mund të përfitonin nga ky ligj pasi do të merrnin eksperiencë duke ndihmuar komunitetin nëpërmjet kontratës dhe librezës së vullnetarit

²⁶ Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë fq. 16

²⁷ Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë fq. 56

një kontratë vullnetarizmi, dokument i cili do të zyrtarizohet dhe vërtetonte angazhimin si vullnetar.

Aktet nënligjore të ligjit që bënin të zbatueshme mundësitë për të rinjtë dolën 3 vjet pas hyrjes së tij në fuqi në kudnërshtim me vetë ligjin.

Për ta bërë ligjin funksional duhet që në mënyrë të organizuar zyrat e punës të përshtaten në mënyrë që të krijojnë regjistrin e të gjithë institucioneve publike apo organizatave që do pranojnë vullnetarë, duhet të ndërtohet regjistri i vullnetarëve dhe të krijojnë mekanizmat financiarë dhe administrativë për të trajtuar sigurimin e shëndetit për vullnetarët.

6.

Krijimi i fondit mbështetës për të rinjtë duke filluar nga 2016 me një fond prej 10,000,000 lekë dhe me një rritje progresive 10% në vite.²⁸

I Pa mbajtur

Fondi mbështetës për të rinjtë nuk u krijua dhe nuk u rrit progresivisht siap parashikimit.

7.

Përgatitja e Kartës Rinore dhe ekuivalentimi me Kartën Evropiane për Rininë.²⁹

I Pa mbajtur

Në Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë Karta Rinore parashikohej të ishte një mjet që do e përfitonin 697,000 të rinj të moshës 15 – 29 vjeç të cilët do të ëprfitonin shërbime brenda dhe jashtë vendit. Karta do të kushtonte 1 euro copa dhe fondi për realizimin saj ishte menduar që të futej tek fondet e pambuluara.

²⁸https://www.un.org.al/sites/default/files/plani%20kombetar%20i%20veprimit%20per%20rinine%202015-2020_Shqip.pdf

²⁹ Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë fq. 29

8.

Ulja e numrit të nxënësve në ngarkim për çdo punonjës social dhe psikolog shkollor.³⁰

Pjesërisht i Mbajtur

Shqipëria ka 520,759 nxënës nga kopështi deri në shkollën e mesme por vetëm 413 psikologë dhe punonjës socialë duke llogaritur edhe ata të institucioneve arsimore private. Raporti i thjeshtë tregon se një psikolog mbulon afro 1260 nxënës, fakt ky që konfirmon shqetësimin e psikologëve shkollorë për ngarkesën e lartë.

Sipas urdhrimit të ish-ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Lindita Nikolla, 3 prill 2018 thuhet se “Në institucionet e arsimit të mesëm të lartë të sigurohet një psikolog dhe një punonjës social për 1800-2300 nxënës, ndërsa për çdo institucion të arsimit të mesëm të llojit gjimnaz me mbi 700 nxënës të sigurohet një psikolog ose një punonjës social.”

Megjithatë, edhe pse ky urdhër do të shtonte numrin e psikologëve në shkollat e vendit, përsëri psikologët detyrohen të mbulojnë disa shkolla apo kopështe njëherësh. Të dhënat që vijnë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Urdhri i Psikologut thonë se në të gjithë vendin në shkollat publike punojnë 227 psikologë.

9.

Ngritja e të paktën një Qendre “Shërbime Miqësore për të Rinjtë” në çdo Prefekturë.³¹

I Pa mbajtur

Nisma Qendra “Shërbime Miqësore për të Rinjtë” rezultoi një nismë e mbetur vetëm në letër pasi nuk u hodh asnjë hap serioz për ta implementuar.

³⁰ Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë fq. 32

³¹ Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë fq. 35

10.

100% e shkollave të arsimit parauniversitar të pajisura me të paktën një klasë me tabela interaktive multimediale.³²

I Pa mbajtur

Një nga objektivat që duhet të ishte realizuar sot nga qeveria në favor të të rinjve është fakti se 100% e shkollave të arsimit parauniversitar duhet të ishin të pajisura me të paktën një klasë me tabela interaktive multimediale, apo të ashtuquajturat “klasa dixhitale”.

Në vitin 2014 qeveria shqiptare mori një kredi prej 3.5 milionë eurosh nga banka austriake, Uni-Credit, për të blerë tableta me justifikimin e përfshirjes së teknologjisë në ato që i quante 120 klasat “dixhitale”. Projekti kishte si qëllim që nxënësit e gjimnazeve në të gjithë vendin të mund të zhvillonin mësimin e disa lëndëve shkollore përmes tableteve elektronike, të cilat kërkojnë lidhje me internetin për të funksionuar. Ky projekt rezultoi i dështuar dhe viti 2020 kur këto klasa mund të shërbenin për të lehtësuar efektet e pandemisë e gjeti Shqipërinë me 0 klasa dixhitale.

³² Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë fq. 43

PREMTIMET E PLANIT TË VEPRIMIT PËR RININË 2015 - 2020

FORCAT QEVERISËSE:
PARTIA SOCIALISTE DHE LËVIZJA
SOCIALISTE PËR INTEGRIM



	Premtimi	Realizimi	Efektiviteti
1	Ngritja e Shërbimit Kombëtar të Rinisë në Tiranë dhe ngritja e Qendrave Rajonale në çdo rajon.		
2	Portali i këshillimit të karrierës për të rinjtë www.rinia.al		—
3	AMSHC krijon fondin specifik, ku 20 % e fondeve duhet të shkojnë për organizatat rinore		—
4	Krijimi Bordit Rinor Këshillimor në MMSR		—
5	Hartimi i Ligjit mbi Vullnetarizmin		
6	Krijimi i fondit mbështetës për të rinjtë duke filluar nga 2016 me një fond prej 10,000,000 lekë dhe me një rritje progresive 10% në vite.		—
7	Përgatitja e Kartës Rinore dhe ekuivalentimi me Kartën Evropiane për Rininë.		—
8	Ulja e numrit të nxënësve në ngarkim për çdo punonjës social dhe psikolog shkollor.		—
9	Ngritja e të paktën një Qendre "Shërbime Miqësore për të Rinjtë" në çdo Prefekturë.		—
10	100% e shkollave të arsimit parauniversitar të pajisura me të paktën një klasë me tabela		—

I MBAJTUR JO EFEKTIV | I PAMBAJTUR EFEKTIV | PJESËRISHT I MBAJTUR DISI EFEKTIV

Per me shume infomacion vizitoni www.qq.com.al

Shtojca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 135/1 Prot.

Tiranë, më 27.1. 2021

Lënda: Kthim përgjigje.

ORGANIZATËS QËNDRESA QYTETARE

Rruga "Hoxha Tahsim", Pallati "Vjero" Ap. 23A,

Tiranë

Në përgjigje të kërkesës tuaj "Kërkesë për informacion", datë 07.01.2021, protokolluar në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë me nr. prot. 135, datë 11.01.2021, ju sqarojmë si më poshtë:

- Lidhur me kërkesën "Numri i shkollave publike të arsimit parauniversitar të cilat sigurojnë ushqim për nxënësit", bëjmë me dije se janë 5 shkolla gjithsej, ku 3 janë në Tiranë, 1 është në Korçë dhe 1 është në Vlorë.
- Për kërkesën "Numri i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara", informojmë se për vitin shkollor 2020-2021, numri i mësuesve ndihmës në arsimin parauniversitar, i ndarë sipas niveleve arsimore, paraqitet si më poshtë:

Nr.	Nivelet arsimore	Publik	Privat	Gjithsej
1	Kopshte	56	63	119
2	Arsimi Bazë	1,089	34	1,123
3	Gjimnaz	26	2	28
4	Shkolla të mesme të orientuara	5	0	5
Total		1,176	99	1,275

- Lidhur me kërkesën "Numri i shkollave publike të kthyer në qendra komunitare", bëjmë me dije se bazuar në statistikat e marra për vitin shkollor 2019-2020 numri i shkollave qendër komunitare në sistemin e arsimit parauniversitar publik është 270 shkolla gjithsej.
- Përsa i përket kërkesës "Sasia e kurrikulave të arsimit parauniversitar të digjitalizuara", informojmë se, në sistemin arsimor parauniversitar, gjendja është si më poshtë vijon:
 - 21 tituj me përmbajtje digjitale në klasën e 10-të;
 - 15 tituj me përmbajtje digjitale klasa e 11-të;
 - 23 tituj me përmbajtje digjitale klasa e 12-të;Në total janë 59 tituj nga klasa 10-të deri në klasën e 12-të.
- Lidhur me kërkesën "Numri i shkollave të reja publike të ndërtuara nga viti 2017 në Shqipëri", ju bëjmë me dije se në bazë të realizimit të buxhetit të investimeve të

Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, numri i shkollave të reja të ndërtuara për periudhën 2017-2019 është 7 shkolla të reja dhe 113 shkolla të rehabilituara.

Gjithashtu, sqarojmë se, për vitin 2020, investimet për arsimin janë menaxhuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Ministria e Rindërtimit.

- Ndërkaq, për kërkesat "Numri i qendrave të punësimit dhe karrierës" dhe "Numri total i shkollave publike profesionale në të gjithë territorin e Shqipërisë", ju bëjmë me dije se Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk disponon informacion, pasi nuk janë në fushën saj të përgjegjësisë.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Alqi KUSHI



PRIORITETET PËR RININË DHE ARSIMIN 2021 – 2025

Qëndresa Qytetare në kuadër të nismës "Arsimi dhe Rinia në fokus", me mbështetjen e Olof Palme Center ka marrë përsipër të evidentojë prioritetet që kanë studentët dhe të rinjtë sot me qëllim ndikimin dhe përmirësimin e ofertave të partive politike mbi arsimin edhe rininë.

Këto prioritete kanë dalë si rezultat i zhvillimit të 20 intervistave gjysëm të strukturuar dhe dy fokus grupeve me studentë dhe të rinj aktivë, të cilët kanë shprehur qëndrimet dhe opinionet e tyre mbi çështjet që ata presin të trajtohen dhe marrin zgjidhje në programet e partive politike. Tre fushat kryesore ku jemi ndalur janë arsimi i lartë, arsimi parauniversitar dhe rinia duke dashur që këto fusha të ndikojmë axhendën e subjekteve zgjedhore, me qëllim rritjen e shkallës së përfitimit të këtyre grupeve të interesit nga platoformat politike.

Arsimi i Lartë



• VETINGU NË ARSIMIN E LARTË

Me qëllim arritjen e një arsimimi cilësor të bazuar në punë shkencore, në lektorë meritorë dhe profesionistë, sugjerojmë të kryehet një proces administrativ i kontrollit të titujve, teksteve, integritetit dhe profesionalizmit të akademikëve nëpërmjet një komisioni ad – hoc të posaçëm, të pavarur ekspertësh dhe nën mbikqyrjen e Komisionit Parlamentar të Arsimit.

Ky proces përfshin:

- Kontrollin e ligjshmërisë së titujve dhe gradave shkencore në vend.
- Kontrollin dhe rishikimin e kurrikulave universitare, duke pastruar sistemin arsimor nga tekstet e kopjuara dhe të vjetëruara
- Kontroll i pasurisë për të gjithë drejtuesit e universiteteve në aspektin akademik dhe administrativ
- Kontroll anti – plagjiaturë për të gjitha punimet shkencore të stafëve akademike në vend.

• LIGJI 80/2015 PËR ARSIMIN E LARTË

5 vjet pas hyrjes në fuqi, ky ligj ka sjellë pasoja juridike dhe institucionale të cilat janë kristalizuar nëpërmjet 36 akteve nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në studimet tona dhe mendimet e ekspertëve më të mirë të arsimit në vend sugjerohet që ligji të ndryshojë si më poshtë:

- Rritja e peshës së votës studentore nga 10% në 30%
 - Rritja e autonomisë në hartimin e kurrikulave nga ana e stafëve akademike nga 20% në 40%
 - Ligjërimit i “distance learning” sipas standarteve më të mira ndërkombëtare
 - Aplikimi i Kredisë Studentore
 - Vlerësim real i pedagogëve nga studentët.
- **LIDHJA E UNIVERSITETIT ME TREGUN E PUNËS ËSHTË NJË PROBLEMATIKË QË LIDHET ME MUNGESËN E NJË SISTEMI RREGULLUES TË TREGUT TË PUNËS.**

Ne sugjerojmë:

- Hartimin e një Strategjie Kombëtare për Arsimin e Lartë dhe i një plan veprimi për përshtatjen e kurrikulave me tregun vendas të punës, sipas prioriteteve të qendrave universitare.
 - Aktivizimin e qendrave të karrierës në universitete
 - Nënshkrimin e marrëveshjeve paraprake me kompani private për përgatitjen e profesionistëve të rinj në funksion të tyre.
 - Lehtësira fiskale për kompanitë që punësojnë studentët e sapodiplomuar dhe kuota të detyrueshme për punësimin e të rinjve.
- **SHËRBIMET ADMINISTRATIVE NDAJ STUDENTËVE DUHET TË FACILITOHEN NËPËRMJET:**
- Kartës së Studentit si një dokument i buxhetuar nga shteti dhe me juridiksion kombëtar jo lokal.
 - Ngritja e infsatrukturës universitare për mundësimin e mësimin në distance
 - Digjitalizim i kurrikulave universitare në një bibliotekë online.
 - Hartimit të rregulloreve të brendshme të Fakulteteve dhe digjitalizimit të shërbimeve ndaj studentëve.
 - Aplikim i Kredisë studentore sipas parashikimeve në ligjin 80/2015



➤ **Arsimi Parauniversitar duhet të përmirësohet në këto drejtime:**

- Nga 1 psikolog per 3 shkolla, duhet të kemi 3 psikologe për 1 shkollë, në mënyrë që nxënësit të kenë mundësi të takojnë psikologun të paktën njëherë në dy javë.
- Rritja e kapaciteteve infrastrukturore në shkolla, si laboratorë, palestra, kompjutera dhe digjitalizimi i procesit të mësimit dhe kurrikulave.
- Zyra karriere funksionale në dispozicion të maturantëve duke i ndihmuar në zgjedhjen e preferencave të tyre për të studiuar në universitet.
- Zhvlerësim i notës mesatare si kriter pranues në universitete dhe fuqizim i konkurseve.

RINIA



Infrastruktura rinore

- Për të krijuar mundësi për angazhimin dhe përfshirjen e të rinjve në jetën sociale dhe publike si edhe për zhvillimin e aftësive të tyre në arta apo teknologji duhet që minimalisht cdo njësi administrative me mesatarisht 50 000 banorë të ketë qendrën e saj rinore dhe bibliotekën e saj.
- Qëndrat rinore duhet të reformojnë qasjen e tyre ndaj të rinjve, duke siguruar një program ditor apo javor dhe jo të shërbejnë si ambiente me qera për OJF-të rinore.
- Krijimi i minimalisht 12 inkubatorëve të bizneseve rinore që nxisin start up-et e inovacionit, teknologjisë dhe inicitvës së lirë nag të rinjtë.

Organizatrat rinore

- Krijimi i një fondi të dedikuar për të mbështetur organizatat rinore.
- Transparencë dhe integritet në funksionimin e Agjensisë Kombëtare të Rinisë.
- Lehtësira fiskale dhe procedurale në themelimin dhe funksionimin e organziatave të të rinjve, taksa 0.
- Zbatim rigoroz, transparent dhe nxjerrje në kohë e akteve nënligjore të ligjit për rininë.



QENDRESA
QYTETARE



OLOF PALME
INTERNATIONAL
CENTER

